



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 89 AKTI

NR. 139 VENDIMI

Tiranë, më 15.4.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Pamela Qirko	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në datën 15.4.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla 1, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Albina Spaha**, gjyqtare/kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim “Kushtetuta”).

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”);

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, njëkohësisht kryetare e kësaj gjykate dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.1.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi është caktuar me short trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete.

Në mbledhjen e trupës gjyqese të datës 24.1.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupës gjyqese, komisionere Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyqese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim IKLP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, për subjektin e rivlerësimit, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha.*

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 23.4.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 7.3.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit në datën 11.3.2019. Subjekti i rivlerësimit në datën 13.03.2019 u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të saj, shoqëruar me dokumentacion plotësues deri në datën 28.3.2019.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, në datën 5.4.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.4.2019, ora 12:00, në Sallën e Seancave Dëgjimore (Pallati i Koncerteve), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e vet në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Albina Spaha ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur brenda afateve të përcaktuara gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personit të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur;
- e) gjetjet dhe rekomandimet e vëzhguesit ndërkombëtar.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 27.1.2017, **subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, deklaroi këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të saj:

1. Apartament me sip. 121,8 m² në Tiranë me adresë: Rr. “****”, ap. ***, k. ***, Njësia Bashkiake Nr. ***. Në bashkëpronësi: 50% me 50%, nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin. Vlera: 4.558.000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime familjare.

Në lidhje me këtë apartament subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion:

- *Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 27.8.2007, me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k. dhe palë blerëse, znj. L. S., për blerjen e apartamentit me sip. 121,8 m² në vlerë 48.000 USD;*
- *Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 4.9.2007, nga ZVRPP-ja Tiranë, për apartament me sip. 121,8 m², në pronësi të znj. L.S.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a.;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera të shërbimeve financiare;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Shkresë nr. *** prot., datë 13.11.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier;
- Shkresë nr. *** prot., datë 13.11.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Arsyetimi ligjor

Këtë pasuri subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën periodike të pasurive dhe interesave të vitit 2007.

Sipas akteve shkresore të siguruara gjatë hetimit administrativ, kjo pasuri është objekt i dy kontratave me shoqërinë “***” sh.p.k.: një kontratë sipërmarrjeje e datës 20.12.2000 dhe një kontratë shitjeje e datës 17.8.2007.

Nga ZVRPP-ja Tiranë rezulton që të jenë pasqyruar rregullisht veprimet juridike në lidhje me këtë pasuri, që nga regjistrimi fillestar i saj dhe deri në transaksionin e fundit, sipas kontratës së shitblerjes datë 17.8.2007, pas së cilës ZVRPP-ja Tiranë lëshoi certifikatën e pronësisë, duke konfirmuar shitjen e tij sipas vetëdeklarimit të subjektit.

Hetimi i kryer nga Komisioni u fokusua në saktësinë e deklarimit të subjektit i rivlerësimit nisur nga mospërputhjet mes deklarimeve periodike, përmbajtjes së kontratave, kronologjisë së pagesave dhe pagesën totale sipas këtyre akteve juridike.

1. Në deklaratën “Vetting” deklarohet apartament në vlerën **4.558.000 lekë**;
2. Në deklaratën periodike të vitit 2007 deklarohet apartament në vlerën **44.000 USD**;
3. Në kontratën e shitblerjes (viti 2007) përcaktohet çmimi **48.000 USD**;

4. Ndërsa në kontratën e sipërmarrjes (viti 2000) përcaktohet çmimi **55.300 USD**.

Sipas kontratës së sipërmarrjes, palët kanë deklaruar se në datën e nënshkrimit:

- është likuiduar kësti i parë prej 35/50% të vlerës (i korigjuar);
- kësti i dytë prej 35/40% të vlerës (i korigjuar) do të paguhet tre muaj pas nënshkrimit të kontratës;
- kësti i tretë prej 30/10% të vlerës (i korigjuar) do të paguhet në fillim të shtrimit të pllakave (shtatë muaj nga lidhja e kontratës së parë).

Për sa më sipër, për periudhën deri në fund të vitit 2001 duhej të ishte likuiduar i gjithë çmimi i apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2000.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për shkak të mospërputhjeve të konstatuara më sipër.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *nuk ka respektuar rendin e pagesave sipas kontratës së sipërmarrjes, pasi pagesën e të gjithë shumës e ka bërë në vitin 2007 për çmimin total prej 42.630 USD, sipas kontratës së shitblerjes, datë 17.8.2007 (ku deklarohet likuidimi i çmimit në cash, por pa e përcaktuar datën), si dhe pagesat e tjera për regjistrimin e pronësisë (të cilat në total arrijnë në vlerën 44.000 USD).*

Këtë deklaramin subjekti i rivlerësimit e mbështeti në materialet shkresore, si: kontratat e sipërmarrjes dhe të shitblerjes, në deklaratën e njërit prej ish-administratorëve të shoqërisë “****” sh.p.k. (sepse sot kjo shoqëri është çregjistruar), si dhe në dokumentacion që provon njohje të vjetër mes bashkëshortit të subjektit dhe deklartuesit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, në mbështetje të pretendimit, i paraqiti Komisionit një analizë financiare të kryer nga ana e saj.

Duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye një analizë financiare për të verifikuar saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime.

Nga analiza financiare për periudhën 1994 – 2001 (pa përfshirë shpenzimet jetike, të mobilimit të apartamentit në Tepelenë, si dhe shpenzime të tjera të kryera në këtë periudhë) është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për pagesën e çmimit të apartamentit, sipas përcaktimeve në vlerë dhe në kohë në kontratën e sipërmarrjes.

Analiza e dërguar nga subjekti i rivlerësimit (për blerjen e apartamentit në Tiranë) nuk u çmua e saktë nga Komisioni, pasi nuk është bazuar në dokumentacion ligjor, si dhe në të nuk janë pasqyruar dhe nuk janë llogaritur shpenzimet e përafërta jetike, të arredimit të apartamentit në Tepelenë, as shpenzime të tjera të kryera nga subjekti dhe familja e subjektit për periudhën 1994 – 2001.

Analiza financiare krahasuese paraqitet më poshtë:

Analizë financiare, periudha 1994 – 2001	Rezultatet e hetimit	Shpjegime të subjektit	Komisioni pas shpjegimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhura <i>neto</i> , paga subjekti për periudhën 1996 - 2001	1431843	1431843	1431843

Të ardhura <i>neto</i> , bashkëshorti për periudhën 1994-2001	3435387	3435387	3435387
Total të ardhura	4867230	4867230	4867230
Ndryshim mjete monetare gjendje fillim - gjendje fund periudhe (depozita RZB)	-1148854	-1148854	-1148854
Mjete monetare të disponueshme (1)	3718376	3718376	3718376
Paguar për blerje apartamenti në Tepelenë, viti 1996	680000	680000	680000
Pagesë çmimi i blerjes së apartamentit referuar kontratës së sipërmarrjes, vitet 2000 - 2001	7828268	0	7828268
Pagesë për blerje makine, viti 2001	500000	500000	500000
Total pagesa për blerje pasurie	9008268	1180000	9008268
Detyrime	0	0	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	9008268	1180000	9008268
Balanca e fondeve (1-2)	-5289892	2538376	-5289892

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të dokumentojë kohën, vlerën e paguar dhe burimet financiare për pagesat në lidhje me blerjen e apartamentit në rrugën “**”, Tiranë sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2000.**

Sipas kontratës së shitblerjes të nënshkruar në vitin 2007, palët kanë deklaruar se deri në datën e nënshkrimit të saj janë likuiduar 48.000 USD, pa përcaktuar kohën dhe mënyrën e likuidimit.

Subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimin se:

- 1) për blerjen e apartamentit të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007 janë përdorur të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2007 dhe është pakësuar gjendja *cash* e deklaruar më parë në shumën prej 1.500.000 lekësh (deklaruar në shkresën dërguar ILDKPKI-së, datë 4.2.2009);
- 2) likuidimi i apartamentit është bërë deri në vitin 2007, duke përdorur kursimet e mbartura.

Bazuar në këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizoi mundësinë financiare nga burime të ligjshme të ardhurash për krijimin e vlerave monetare *cash* në banesë, të deklaruara për vitet 2005 dhe 2006, të pretenduara se janë përdorur për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie. Nga analiza financiare në këtë drejtim rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme krijimin e gjendjes së likuideteve *cash* në shumën prej 700.000 lekësh në vitin 2005 dhe në shumën prej 2.300.000 lekësh për vitin 2006. Këto rezultate të analizës financiare iu komunikuan subjektit të rivlerësimit, ndaj të cilave subjekti ngriti pretendimin se:

Për rezultatin e analizës së vitit 2005

“Në analizën për vitin 2005 janë llogaritur ndryshimet e bankës në vlerën 1.485.786 lekë, ndërkohë që shuma prej 1.300.000 lekësh është derdhur prej bashkëshortit në datën 19.1.2005, datë kur maturahej depozita. Kjo shumë është përfshirë nga ana ime në DPV-në 2004, pasi në fakt kjo shumë vjen nga kursimet e vitit 2004 e më parë dhe, për pasojë, nuk mund të përfshihet në analizën e fondeve të vitit 2005. Vetë fakti që shuma është derdhur më 19.1.2005, vërteton se kjo shumë nuk mund të rezultojë nga të ardhurat e vitit 2005”.

“Në lidhje me këtë depozitë më duhet të sqaroj se, depozita ka qenë me afat 3-mujor dhe maturahej në datën 19.1.2005 dhe vlera pas maturimit ka qenë 1.366.041 lekë. Në datën 19.1.2005 është

rihapur depozita me afat 12-mujor, ku vlerës së mësipërme i është shtuar shuma 1.300.000 lekë duke bërë që shuma totale e depozitës të jetë në vlerën 2.666.000 lekë. Duke qenë se deklarata periodike vjetore e vitit 2004 është dorëzuar në datën 31.3.2005, gabimisht kam përfshirë edhe këtë shumë (1.300.000 lekë) në depozitë si gjendje, në datën 31.12.2004”.

Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton se gjendjet bankare të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhen me gjendjet e dokumentuara nga bankat. Totali i shtesave në mjete monetare *cash* (deklaruar) + bankë (dokumentuar) në vitin 2005 rezulton në vlerën prej 2.185.786 lekësh (700.000 lekë + 1.485.786 lekë).

Edhe pas shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor, burimet financiare të krijimit të shtesave në mjete monetare në bankë dhe *cash* (deklaruar) në fund të vitit 2005, si dhe huan e dhënë motrës së bashkëshortit, duke rezultuar me **një balancë negative të fondeve në vlerën prej 1.036.229 lekësh.**

Analiza financiare krahasuese paraqitet më poshtë:

Analiza financiare, viti 2005	Rezultatet e hetimit	Shpjegime të subjektit	Komisioni pas prapësimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit të rivlerësimit	880484	880484	880484
Të ardhura e bashkëshortit nga FSHZH + “***” të konfirmuara nga institucionet	1207301	1207301	1207301
Të ardhura të tjera	0	0	0
Total të ardhura	2087785	2087785	2087785
Pagesë shpenzime jetese	438228	438228	438228
Total shpenzime	438228	438228	438228
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> gjendje fillim – gjendje fund periudhe e deklaruar	-700000	-700000	-700000
Ndryshim mjete monetare banke, gjendje fillim – gjendje fund periudhe	-1485786	-185786	-1485786
Mjete monetare të disponueshme (1)	-536229	763771	-536229
Huadhënie	500000	500000	500000
Pagesë për krijim pasurie apartament Tiranë	0	0	0
Detyrime	0	0	0
Pasuri neto (2)	500000	500000	500000
Balanca e fondeve	-1036229	263771	-1036229

Për rezultatin e analizës së vitit 2006

Subjekti i rivlerësimit ngriti pretendimin se:

“Në analizë nuk merret parasysh vlera prej 1.100.000 lekësh, që është e ardhura e përfituar nga bashkëshorti për punën e kryer pranë shoqërisë “***”sh.p.k për vitin 2006. Kjo e ardhur gjen pasqyrim në DPV-në dhe në deklaratën “Vetting”. Në përgjigje të pyetjeve në lidhje me të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti në shoqërinë “***” sh.p.k., kam paraqitur vërtetimet e shoqërisë dhe akte ligjore të marra nga Bashkia Gjirokastrë (të vëna në dispozicion me shkresën me nr. *** prot., datë 13.12.2018, dhe të paraqitura më parë Komisionit) që vërtetojnë marrëdhënien e punësimit pranë kësaj shoqërie”.

Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton se përfitimi dhe shlyerja e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të pretenduara, të përfituara nga bashkëshorti i saj në vitin 2006 (në vlerë 1.100.000 lekë) nga shoqëria “***” sh.p.k., nuk justifikohet me dokumentacion ligjor.

Edhe pas shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor burimet financiare të krijimit të shtesave në mjete monetare në bankë dhe *cash* (deklaruar) në fund të vitit 2006, **duke rezultuar me një balancë negative të fondeve në vlerën prej 665.994 lekësh.**

Analiza financiare krahasuese paraqitet më poshtë:

Analiza financiare, viti 2006	Rezultatet e hetimit	Subjekti i rivlerësimit	Komisioni pas prapësimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit	903677	903677	903677
Të ardhura e bashkëshortit nga FSHZH + “***”, të vërtetuara	1118275	2218275	1118275
Të ardhura të tjera	177737	177737	177737
Total të ardhura	2199689	3299689	2199689
Pagesë shpenzime jetese	438228	438228	438228
Total shpenzime	438228	438228	438228
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> , gjendje fillim – gjendje fund periudhe e deklaruar	-2300000	-2300000	-2300000
Ndryshim mjete monetare banke, gjendje fillim – gjendje fund periudhe	-127455	-127455	-127455
Mjete monetare të disponueshme (1)	-665994	434006	-665994
Huadhënie	0	0	0
Pagesë për krijim pasurie, apartament Tiranë	0	0	0
Detyrime	0	0	0
Pasuri neto (2)	0	0	0
Balanca e fondeve	-665994	434006	-665994

Për rezultatin e vitit 2007

Subjekti i rivlerësimit ngriti pretendimin se:

- “Në analizë nuk merret parasysh fakti i kthimit të shumës prej 500.000 lekësh, dhënë hua motrës së bashkëshortit (kthyer në janar të vitit 2007). Në përgjigjet drejtuar Komisionit jam shprehur se huaja dhënë shtetas M.H., është kthyer diku nga fundi i vitit 2006, ose fillimi i vitit 2007. Dhënia e huas dhe kthimi i saj është bërë në kushtet e mirëbesimit, duke qenë se huamarrësja ishte motra e bashkëshortit. Motra e bashkëshortit ishte emigrante, hyrja dhe dalja e saj nga Republika e Shqipërisë gjen pasqyrim në sistemin TIMS. Referuar aktit nr. *** prot., datë 19.3.2019, shtetasja M.H., ka hyrë në Shqipëri në datën 9.1.2007. Në vitin 2006 nuk ka pasur asnjë hyrje apo dalje nga pikat e kalimit kufitar. Kthimi i shumës së marrë hua është bërë në muajin janar 2007.

- Në analizën për vitin 2007 nuk është marrë parasysh si e ardhur nga paga dhe dieta të bashkëshortit (sipas vërtetimit të shoqërisë “***” shp.p.k të datës 10.12.2018) shuma prej 1.500.000 lekësh, e cila është deklaruar dhe gjen pasqyrim në DPV-në e këtij viti, pasi në vend të kësaj shume në analizë është përfshirë shuma e deklaruar nga ana e shoqërisë si pagë. (Vlen i njëjti arsyetim sikurse edhe më lart në lidhje me pagën e përfituar për kryerjen e punës në këtë shoqëri.)

- Në analizën për vitin 2007 përfshihet si ulje e mjeteve monetare shuma prej 1.500.000 lekësh, ndërkohë që sikurse kam sqaruar, pagesa e apartamentit është kryer nga kursimet e akumuluar deri në vitin 2006 plus një pjesë të kursimeve të vitit 2007. Pra, në realitet nga të ardhurat totale prej 3.166.418 lekësh të vitit 2007 janë kursyer 2.000.000 lekë. Nga këto, 1.058.000 lekë janë përdorur për blerjen e apartamentit, ndërsa pjesa tjetër prej 942.000 lekësh ka mbetur cash në shtëpi në fund të vitit. Pra, lëvizja totale e kursimeve neto për vitin 2007 ka qenë + 2.000.000 kursime – 4.558.000 blerje apartamenti = -2.558.000 lekë”.

Nga shpjegimet e mësipërme, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar vlerën e kursimeve të mbartura, të përdorura për blerjen e apartamentit (referuar deklarimeve të subjektit se apartamenti është blerë në vitin 2007).

Nisur nga shpjegimet e mësipërme, nga Komisioni u krye analiza financiare për vitin 2007 (në vazhdimësi të periudhave paraardhëse) dhe verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Nga sa më sipër rezultoi se:

1. Në lidhje me pretendimin se, likuidimi i apartamentit është bërë deri në vitin 2007, nga subjekti i rivlerësimit nuk provohet mënyra e pagimit të shumës në rrugë bankare apo cash, vlera e çdo kësti dhe koha e pagimit të tij. Në deklaratimet periodike të periudhës 2003 – 2006 nuk është deklaruar pagesë e ndonjë kësti për apartamentin në fjalë.
2. Burimi i deklaruar në këtë rast nuk është i mjaftueshëm, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të justifikojë me dokumentacion ligjor të ardhurat për krijimin e shtesave në mjete monetare në cash (deklaruar) në fund të vitit 2005 dhe 2006 (të cilat deklarohen se janë përdorur si burim për blerjen e apartamentit). Balanca e fondeve për vitet 2005 dhe 2006 është negative përkatësisht në vlerat 1.036.229 lekë dhe 665.994 lekë.

Edhe pas analizës financiare të vitit 2007, mbështetur në deklaratimin e mësipërm të subjektit të rivlerësimit, rezulton se subjekti, znj. Albina Spaha, dhe familja e saj, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vitin 2007 [shtuar kursimeve cash në vlerë 1.500.000 lekë, të deklaruar të pakësuara nga viti paraardhës, përfshirë kthimin e huas në janar 2007, deklaruar (por pa prova)], për shlyerjen e shumës prej 48.000 USD, për krijimin e apartamentit të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007.

Analiza financiare krahasuese paraqitet si më poshtë:

Analiza financiare, viti 2007	Rezultatet e hetimit	Subjekti i rivlerësimit	Komisioni pas prapësimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit	904226	904226	904226
Të ardhurat e bashkëshortit nga FSHZH + “****” të vërtetuara	1118548	2257803	1118548
Kthim huaje/deklarim	0	500000	500000
Të ardhura të tjera	4389	4389	4389
Total të ardhura	2027163	3666418	2527163
Pagesë shpenzime jetese	943872	943872	943872
Total shpenzime	943872	943872	943872
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> , gjendje fillim – gjendje fund periudhë deklaruar	1500000	2558000	1500000
Ndryshim mjete monetare banke, gjendje fillim – gjendje fund periudhe	59440	59440	59440
Mjete monetare të disponueshme (1)	2642731	5339986	3142731
Pagesë për krijim pasurie apartament Tiranë 48.000 USD	3978720	4558000	3978720
Detyrime	0	0	0
Pasuri neto (2)	3978720	4558000	3978720
Balanca e fondeve	-1335989	781986	-835989

Gjithashtu, Komisioni konstatoi se apartamenti në fjalë është përfunduar me çelësa në dorë që në fund të vitit 2001 (sipas aktit të kolaudimit të depozituar në ZVRPP-në Tiranë). Në këtë periudhë rezultojnë që të jenë lidhur kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike, si dhe janë vendosur matësat përkatës në emër bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, duke u faturuar për këtë qëllim.

Nisur nga këto fakte, si dhe nga komunikimet që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur me UKT sh.a., për ndryshim apo saktësim emri në kontratë (në vitin 2004), Komisioni krijoi bindjen se apartamenti në këtë periudhë ka qenë i përfunduar dhe në zotërim të subjektit të rivlerësimit, por nuk rezultoi i deklaruar si aset në deklaratat periodike gjatë viteve 2003 – 2006.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kontratat janë lidhur nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe se në vitin 2004 është bërë ankim nga bashkëshorti për një mbifaturim, të cilin nuk mund ta bënte vetë administratori i shoqërisë ndërtuese. Ky pretendim mbeti në kuadër deklarimi, por pa u mbështetur në prova shkresore të kohës.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Nisur nga dokumentacioni i siguruar gjatë hetimit administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit, apartamentin e ka pasur në përdorim/posedim që në vitin 2002 dhe nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë dhe interesave të viteve 2003 – 2006.

- ✓ Nisur nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “***” sh.p.k., rendi i pagesave sipas kësaj kontrate dhe analizën financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk disponon të ardhura të mjaftueshme dhe aftësi paguese për të gjithë çmimin e kontratës. Në përlogaritjen e vlerës së çdo pasurie të fituar nga subjekti i rivlerësimit, deri më datë 31.12.2001, subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me burime të ligjshme shumën prej 5.289.892 lekësh.
- ✓ Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se likuidimi i apartamentit është bërë deri në vitin 2007, nuk qëndron pasi nuk ka arritur të provojë mënyrën e pagimit të kësaj shume, në rrugë bankare apo cash, vlerën e çdo kësti dhe kohën e pagimit të tij. Burimi i deklaruar në këtë rast nuk është i mjaftueshëm, pasi subjekti nuk ka arritur të justifikojë me dokumentacion ligjor, të ardhurat për krijimin e shtesave në mjete monetare cash (deklaruar) në fund të vitit 2005 dhe 2006 (të cilat deklarohen se janë përdorur si burim për blerjen e apartamentit).
- ✓ Për vitet 2005 dhe 2006 është konstatuar një balancë negative fondesh në vlerat, përkatësisht 1.036.229 lekë dhe 665.994 lekë.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 61,2 m² në Tepelenë, me adresë: lagjja “****”, ap. ***, p. ***, shk. ***, k. ***. Pasuria është fituar nga bashkëshorti para martesë, jashtë regjimit pasuror martesor (100% në pronësi të bashkëshortit). Apartament në përdorim.

Vlera: 680.000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: nga kursimet e bashkëshortit.

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.1996, me palë shitëse, z. H.H., dhe palë blerëse, znj. L.S., për blerjen e apartamentit me sip. 61,2 m² në vlerën prej 680.000 lekësh;*
- *Kërkesë për regjistrim në ZVRPP-në Tepelenë + mandatpagesa nëpërmjet bankës “Societe General Albania” për taksat e regjistrimit;*
- *Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 11.4.2012 nga ZVRPP-ja Tepelenë, për apartament me sip. 61,2 m², në pronësi të znj. L.S.;*
- *Vërtetim datë 25.1.2017 nga OSHEE Gjirokastrë, ku vërtetohet se znj. L.S., ka kontratë me nr. *** me OSHEE-në, agjencia Tepelenë dhe librezë pagesash.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme;
- Shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2018, drejtuar ZVRPP-së Tepelenë;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë” sh.a.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar fillimisht këtë apartament në deklarimin periodik të pasurisë të vitit 2003, duke deklaruar pronësinë e bashkëshortit: apartament, 1+1, 61,2 m², në vlerën prej 750.000 lekësh, ndodhur në lagjen “****”, Tepelenë. Pjesa takuese: 100%.

Nga materialet e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë rezulton se ky apartament është objekt i kontratës së shitblerjes i datës 8.8.1996, me blerës bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit 680.000 lekë, deklaruar se është likuiduar jashtë zyrës noteriale (përpara përpilimit të kontratës).

Kjo pasuri është regjistruar në emër të personit të lidhur në bazë të aplikimit të tij më 26 janar 2012, pas 15 vjet e 6 muajsh nga nënshkrimi i kontratës së shitblerjes, për të cilin nga subjekti i rivlerësimit u kuptua se kjo vonesë nuk justifikohet me ndonjë arsye objektive.

Në procedurat e regjistrimit të pasurisë dhe të lëshimit të certifikatës së pronës, janë llogaritur edhe detyrimet e tatimit për kalimin e pronësisë. Por, nuk rezulton që nga personi i lidhur të jetë likuiduar tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe as nga ZVRPP-ja Tepelenë nuk rezulton që të ketë aplikuar penalitet për vonesën e gjatë të depozitimit të kontratës së shitblerjes, me qëllim regjistrimin e apartamentit në pronësi të personit të lidhur. Nga kjo e fundit, Komisioni u informua se problemi ishte shkaktuar nga specialisti përkatës në atë periudhë, pa shpjegime të tjera.

Për këtë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, e cila shpjegoi se për regjistrimin e kontratës së shitjes së pronës nuk u aplikuan penalitete, pasi Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kishte njoftuar të gjitha zyrat vendore, të cilat nuk i kishin zonat kadastrale në sistem, të mos aplikojnë penalitete për vonesën e aplikimit.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit sollti në dispozicion të Komisionit shkresën e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të datës 19.3.2019, si dhe atë të datës 14.1.1999.

- ✓ Pas hetimit administrativ, Komisioni konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ.

3. Automjet tip “Voksäagen”, me targa AA ** AL, i cili është blerë në shumën prej 8.000 eurosh me kontratën e shitblerjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 14.4.2011. Në bashkëpronësi 50% me 50% nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin.**

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: kursimet familjare.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Kontratë shitblerjeje nr. **** rep., nr. **** kol., datë 14.4.2011, me palë shitëse znj. G.J.M., dhe palë blerëse znj. L.S., për blerjen e automjetit tip “Volksäagen” në vlerën prej 8.000 eurosh;*

- Kontratë bashkëpronësie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2011 midis znj. L.S., dhe znj. Albina Spaha;
- Kërkesë drejtuar DRSHTRR-së Gjirokastrë + përgjigjja e DPSHTRR-së + praktika.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor;
- Shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Gjirokastrë;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare.

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me këtë automjet, subjekti i rivlerësimit, në deklarin periodik të pasurive dhe interesave të vitit 2011, ka deklaruar: “Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.11.2011, prej bashkëshortit është blerë, me kursime familjare, automjeti tip “Golf” në shumën 8.000 euro”. Nuk deklarohet pjesa takuese e saj në përqindje, por bashkëpronësia në pjesë të barabarta prezumohet për të gjitha sendet e fituara gjatë periudhës së martesës, bazuar në nenin 74 të Kodit të Familjes. Këtë fakt, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

Konstatohet se në datën 14.4.2011, personi i lidhur ka blerë këtë pasuri nga shtetasja Gj.M., kundrejt çmimit 8.000 euro, ku në kontratë specifikohet qartë se çmimi është likuiduar *cash* më përpara, jashtë zyrës noteriale.

Fakti i blerjes dhe i origjinës së automjetit konfirmohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Gjirokastrë.

Hetimi i kryer nga Komisioni u fokusua në të ardhurat që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës prej 8.000 eurosh, shumë e cila është likuiduar para nënshkrimit të kontratës së datës 14.4.2011.

Analiza financiare për këtë vit, duke reflektuar dhe shpenzimet e transportit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, paraqitet si më poshtë:

Analiza financiare	Viti 2011
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit	928901
Të ardhurat e bashkëshortit, të vërtetuara	566064
Të ardhura nga qira	180000
Të ardhura të tjera	238781
Total të ardhura	1913746
Pagesë shpenzime transporti, deklaruar	83700
Pagesë shpenzime jetese	546480

Shpenzime total	630180
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> gjendje fillim – gjendje fund periudhe, deklaruar	211440
Ndryshim mjete monetare banke gjendje fillim – gjendje fund periudhe	-109005
Mjete monetare të disponueshme (1)	1386001
Pagesa për krijim pasurie autoveturë “Volksäagen” 8000 euro	1111440
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	1111440
Balanca e fondeve (1-2)	274.561

Për këtë vit subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive të fondeve.

- ✓ Pas hetimit administrativ, Komisioni konkludon se deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pasur aftësi paguese nga burime të ligjshme të të ardhurave për blerjen e automjetit.

4. Automjet tip “Toyota Rav. 4” me targa AA * HN**, i cili është blerë nga bashkëshorti në shumën prej **906.000 lekësh** provuar me faturën tatimore të shitjes nr. *** datë 7.10.2013. Në bashkëpronësi 50% me 50% nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime familjare.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitjeje datë 7.10.2013, me palë shitëse “***” sh.p.k. dhe palë blerëse L. S., për blerjen e automjetit tip “Toyota Rav. 4”, në vlerën prej 906.000 lekësh;
- Faturë tatimore shitjeje për automjetin me nr. ***, datë 7.10.2013, vlera 906.000 lekë.
- Çertifikatë pronësie nr. *** për automjetin tip “Toyota Rav. 4”, me targa AA *** HN në pronësi të znj. L.S.
- Kërkesë drejtuar DRSHTRR-së Gjirokastër + përgjigja e DPSHTRR-së + praktika.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor;
- Shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Gjirokastër;
- Shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2018, drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k.;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë (lidhur me Regjistrin Noterial Shqiptar);
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit për këtë aset, në deklaratën periodike të pasurive dhe interesave në vitin 2013, ka deklaruar: *“Pakësuar kursimet familjare nga blerja e një automjeti “Toyota”, në datën 7.10.2013, nga shoqëria “***” sh.p.k. në vlerën 906.000 lekë; fatura nr. *** datë 07.10.2013”*. Nuk deklarohet pjesë takuese në përqindje, por prezumohet bashkëpronësia në pjesë të barabarta për të gjitha sendet e fituara gjatë periudhës së martesës, bazuar në nenin 74, të Kodit të Familjes. Këtë fakt, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

Fakti i blerjes dhe i origjinës së automjetit konfirmohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Gjirokastrë.

Kontrolli fizik dhe regjistrimi në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Gjirokastrë janë kryer në datën 11.10.2013.

Me faturën e shitjes të datës 7.10.2013 dhe kontratën e datës 7.10.2013, shoqëria “***” sh.p.k. ia shet këtë makinë blerësit, personit të lidhur, kundrejt çmimit prej 906.000 lekësh. Në kontratën e shitblerjes nuk përcaktohet mënyra e likuidimit të çmimit.

Komisioni hetoi mbi mënyrën e likuidimit të çmimit të faturës, aftësinë paguese dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave.

Nga shoqëria “***” sh.p.k. nuk rezultoi informacion, ndërsa nga subjekti i rivlerësimit u deklarua se pagesa ishte kryer *cash* në datën 8.10.2013 (d.m.th., një ditë pas kontratës), pasi në këtë datë bashkëshorti mundi të tërhiqte shumën prej 1.000.000 lekësh nga llogaria e tij në “Alpha Bank” (tek e cila kishte bërë njoftim një ditë më parë, në datën 7.10.2013), pasi banka duhej njoftuar një ditë më përpara për çdo tërheqje të shumave mbi 500.000 lekë.

Nga verifikimi i të dhënave bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, si dhe nga analiza financiare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të mjaftueshme financiare, të ligjshme në shumën prej 406.195 lekësh për të krijuar gjendjen në llogarinë bankare.

Në lidhje me konstatimet e rezultateve të hetimit për analizën financiare të vitit 2013 (vit në të cilin është blerë automjet i tipit “Toyota Rav. 4” nga bashkëshorti në shumën prej 906.000 lekësh provuar me faturën tatimore nr. *** më datë 7.10.2013, të shitjes), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

“Në analizën për vitin 2013 është përfshirë shuma prej 564.096 lekësh si ‘shpenzime jetese’. Nga ana tjetër, në analizë është përfshirë si zë më vete shkollimi dhe transporti, ndërkohë që këta zëra përfshihen në ‘konsum familjar’, kjo po t’i referohemi edhe të dhënave të INSTAT, ku edhe shkollimi, edhe transporti, përbëjnë 2 nga 12 Grupet Kryesore të Konsumit.

Gjithashtu, në analizë është përfshirë si e ardhur nga qiraja shuma prej 660.000 lekësh dhe jo shuma prej 720.000 lekësh, sikurse në fakt rezultoi.

Duke marrë parasysh faktet e sipërpërmendura, duke u ulur shuma e shpenzimeve të shkollimit dhe transportit nga njëra anë, dhe duke u shtuar të ardhurat nga qiraja nga ana tjetër, balanca e fondeve rezultoi pozitive...”

Për efekt të analizës financiare, Komisioni mban si referencë të dhënat mbi konsumin vjetor për frymë në lekë për periudhën 2003 – 2016, sipas shkresës nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, sipas së cilës: *“Treguesit statistikorë merren nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës dhe/ose nga Anketa e Buxhetit të Familjes. Në këto anketa përlllogariten shpenzimet minimale në shkolla shtetërore dhe nuk përfshihen shpenzimet për shkollim në institucione jopublike.”*

Në lidhje me shpenzimet e shkollimit (të dokumentuara nga shkolla jopublike “****”) dhe të transportit (të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit si shpenzime për autoveturën), Komisioni konstaton se këto shpenzime në total zënë afro 62 % të konsumit vjetor të familjes referuar të dhënave nga INSTAT-i {(162.000 + 190.000) : 564.096}, e cila është shumë më e lartë edhe se shpenzimet për ushqime. Për këtë arsye, ato shtohen në shpenzime, sikurse është bërë llogaritja.

Më tej, Komisioni hetoi dhe analizoi mbi të ardhurat e deklaruara nga dhënia e këtij apartamenti me qira shtetasit P.R., në periudhën 7.10.2011 – 27.12.2013, bazuar në kontratën e qirasë së datës 17.10.2011 (me afat 5-vjeçar, kontratë e peregjistruar në ZVRPP-në Tiranë), por të revokuar nga palët në datën 27.12.2013, për shkak se apartamenti nuk u përdor për banim nga qiramarrësi.

Komisioni ngriti dyshime mbi përfitimin real të qirasë mujore dhe vendosi t’i kalojë barrën e provës subjektivit të rivlerësimit. Sipas formulimit të kontratës së qirasë dhe formulimit të deklaratës së zgjidhjes së saj, duke marrë në konsideratë edhe faktin që palët deklarojnë se apartamenti nuk u përdor sipas objektit të kontratës, nuk rezultoi që qiramarrësi të ketë likuiduar qiranë mujore për 27 muaj (përafërsisht në shumën 1.620.000 lekë).

Komisioni hetoi të ardhurat e deklaruara nga shtetasi P.R., prej të cilave rezultoi se me to nuk mund të realizohej pagesa e qirasë.

Nga hetimi administrativ u konstatua se një vit pas revokimit të kontratës së qirasë, në datën 27.11.2014, bashkëshorti i subjektivit të rivlerësimit ka paguar në “Alpha Bank” shumën prej 156.000 lekësh me përshkrimin: *tatim në burim për qira godine, nr. *** rep., nr. *** kol.* (pa datë). Gjithsesi, edhe pse kjo pagesë paraqet të meta formale, veprimi bankar konfirmohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, me shkresën e saj, datë 19.3.2019.

Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë, në analizën financiare të Komisionit ato janë pasqyruar referuar kontratës së qirasë së datës 7.10.2011 (për sa i përket shumës së qirasë, kohës së fillimit) dhe vlerës së paguar të tatimit mbi qiranë. Shuma e tatimit të paguar është 156.000 lekë dhe i përgjigjet të ardhurave në vlerën prej 660.000 lekësh në vitin 2013 (11 muaj x 60.000 lekë). Për këtë përlllogaritje, Komisioni mban në konsideratë përcaktimet e pikës 3 (fjalë e dytë), të nenit D, të ligjit nr. 76/2016 (Aneksi i Kushtetutës), sipas të cilit: *“Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*.

Në analizën financiare të vitit 2013, Komisioni nuk ka përfshirë transfertat për z. A.S., nga llogaria e bashkëshortit të subjektivit në “Alpha Bank”, në shumën prej 170.000 lekësh, si dhe ka zbritur nga vlera mesatare e shpenzimeve të karburantit shumën prej 13.500 lekësh [(12.000 lekë + 1.500 lekë) : 2] dhe shumën prej 4.200 lekësh në muaj (200 lekë në ditë x 21 ditë), të deklaruara nga

subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Këto shuma u përkasin shpenzimeve të transportit me mjete të tjera, të përfshira në shpenzimet e konsumit vjetor për frymë. Në analizën financiare pasqyrohet si shpenzim karburanti shuma e reduktuar 102.300 lekë në vit (13.500 lekë - 4.200 lekë) x 11 muaj.

Edhe pas shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor burimet financiare për blerjen e autoveturës tip “Toyota Rav 4” në vitin 2013. Subjekti i rivlerësimit **rezulton me balancë negative fondesh në shumën prej 346.495 lekësh.**

Analiza financiare krahasuese paraqitet më poshtë:

Analiza financiare, viti 2013	Rezultatet e hetimit	Shpjegimet e subjektit	Komisioni pas shpjegimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit	1127788	1127788	1127788
Të ardhurat e bashkëshortit, të vërtetuara	409760	409760	409760
Të ardhura nga qira	660000	720000	660000
Të ardhura të tjera	182760	182760	182760
Total të ardhura	2380308	2440308	2380308
Pagesë shpenzime transporti, deklaruar	162000	0	102300
Shpenzime shkollimi	190000	0	190000
Pagesë shpenzime jetese	564096	564096	564096
Total shpenzime	916096	564096	856396
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> gjendje fillim – gjendje fund periudhe	-274000	-274000	-274000
Ndryshim mjete monetare banke gjendje fillim – gjendje fund periudhe	-690407	-690407	-690407
Mjete monetare të disponueshme (1)	499805	911805	559505
Pagesa për krijim pasurie autoveture “Toyota Rav 4”	906000	906000	906000
Detyrime	0	0	0
Pasuri neto (2)	906000	906000	906000
Balanca e fondeve (1-2)	-406195	5805	-346495

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 nuk përputhet me dokumentacionin e siguruar gjatë hetimit administrativ dhe me analizën ekonomike.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur aftësi pagueuse nga të ardhurat e konfirmuara me dokumentacion ligjor nga institucionet për blerjen e automjetit.

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme në shumën 346.495 lekë, për blerjen e automjetit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të analizuara.

5. Llogari rrjedhëse në bankën “Societe General Albania”, në emër të subjektit të rivlerësimit.

Gjendja: 114.572,74 lekë (deri në datën 23.1.2017).

Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: kursime nga të ardhurat nga pagat.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Konfirmim bankar “Societe General Albania” me nr. *** prot., datë 23.1.2017, sipas së cilës gjendja e llogarisë së pagës së znj. Albina Spaha, në datën 23.1.2017 është 114.572 lekë;
- Nxjerrje llogarie e pagës së “Societe General Albania”, datë 23.1.2017.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare;
- Shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2018, drejtuar bankës “Societe Generale Albania”.

Arsyetimi ligjor

Nga përgjigjja e bankës “Societe Generale Albania” konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka llogari rrjedhëse në këtë bankë që prej datës 3.1.2014, e cila deri në datën 8.2.2018 ka gjendje në shumën 290.857,54 lekë. Me përgjigjen e dhënë, banka ka bashkëlidhur pasqyra me të gjitha veprimet që janë kryer në këtë llogari.

Referuar dokumentacionit ligjor të disponuar nga Komisioni, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se për vitin 2014 (vit në të cilin është hapur kjo llogari), **rezulton një balancë negative fondesh në vlerën prej 154.498 lekësh.**

Analiza financiare krahasuese paraqitet më poshtë:

Analiza financiare, viti 2014	Rezultatet e hetimit	Shpjegimet e subjektit	Komisioni pas shpjegimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit	1365256	1365256	1365256
Të ardhurat e bashkëshortit, të vërtetuara	342200	342200	342200
Të ardhura të tjera	26488	26488	26488
Total të ardhura	1733944	1733944	1733944
Shpenzime shkollimi	518168	0	518168
Shpenzime transport, deklaruar	162000	0	102300

Shpenzime të tjera	156000	156000	156000
Pagesë shpenzime jetese	879992	879992	879992
Total shpenzime	1716160	1035992	1656460
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> , gjendje fillim – gjendje fund periudhe, deklaruar	-620000	-620000	-620000
Ndryshim mjete monetare banke gjendje fillim – gjendje fund periudhe	388018	388018	388018
Mjete monetare të disponueshme (1)	-214198	465970	-154498
Pagesa për krijim pasurie	0	0	0
Detyrime	0	0	0
Pasuri neto (2)	0	0	0
Balanca e fondeve (1-2)	-214198	465970	-154498

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, për gjendjen në llogarinë rrjedhëse në bankën “Societe Generale Albania” përputhet me dokumentacionin e bankës.
- ✓ Nisur nga dokumentacioni ligjor i të ardhurave nga burime të ligjshme, nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për shtesa në gjendje *cash*, ndryshime të vlerave monetare në bankë, si dhe nga informacionit për shpenzime të kryera për këtë vit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar si gjendje shumë e lënë në këtë llogari bankare, shtesën e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2014.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, për krijimin e gjendjes së llogarisë bankare në shumën 154.498 lekë.

6. Llogari rrjedhëse në emër të bashkëshortit, në “Intesa SanPaolo Bank”

Gjendja: 309.826,88 lekë (deri në datën 24.1.2017).

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga paga.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Gjendje e klientit datë 24.1.2017 dhe nxjerrje llogarie “Intesa SanPaolo Bank”, datë 24.1.2017, gjendja e llogarisë së znj. L.S., datë 24.1.2017 është 309.826 lekë.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare.

Arsyetimi ligjor

Nga përgjigjja e kthyer nga “Intesa SanPaolo Bank”, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, ka hapur llogari pranë kësaj banke në datën 31.3.2015. Gjendja në këtë llogari në datën 31.12.2015 është në vlerën 248.825 lekë, ndërsa në datën 31.12.2016 është në vlerën 309.827 lekë.

Kreditimi i kësaj llogarie ka si burim pagat nga shoqëria “****” sh.p.k. Sipas shkresës së bankës konfirmohet vetëdeklarimi për shumën 309.826,88 lekë në “Intesa SanPaolo Bank” deri në datën 27.1.2017. Marrëdhënia e punës së personit të lidhur me këtë shoqëri konfirmohet edhe nga të dhënat e DRSSH-së Gjirokastër.

Referuar dokumentacionit në dispozicion, si dhe deklarimeve të mësipërme, duket se për vitin 2015 (vit në të cilin është hapur kjo llogari), rezulton një balancë negative fondesh në vlerën prej 8.057 lekësh, konkretisht:

Analiza financiare krahasuese paraqitet më poshtë:

Analiza financiare, viti 2015	Rezultatet e hetimit	Shpjegimet e subjektit	Komisioni pas shpjegimeve
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit	1246437	1246437	1246437
Të ardhura e bashkëshortit, të vërtetuara	1111137	1111137	1111137
Të ardhura të tjera	12576	12576	12576
Total të ardhura	2370150	2370150	2370150
Shpenzime shkollimi	370275	0	370275
Shpenzime udhëtimi në SHBA, deklaruar	350000	350000	350000
Shpenzime transporti, deklaruar	162000	0	102300
Pagesë shpenzime jetese	897104	897104	897104
Total shpenzime	1779379	1247104	1719679
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> , gjendje fillim – gjendje fund periudhe, deklaruar	-290000	-290000	-290000
Ndryshim mjete monetare banke gjendje fillim – gjendje fund periudhe	-368528	-368528	-368528
Mjete monetare të disponueshme (1)	-67757	464518	-8057
Pagesa për krijim pasurie	0	0	0
Detyrime	0	0	0
Pasuri neto (2)	0	0	0
Balanca e fondeve (1-2)	-67757	464518	-8057

Referuar të dhënave nga kjo bankë, rezulton që në datën 20.6.2016, në llogarinë në lekë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është transferuar shuma prej 42.500 lekësh, me

përshkrimin “Gjykata Administrative, pagesë eksperti, sipas vendimit nr. *** akti, datë 17.5.2016, pika nr. 1”.

Kjo shumë nuk është deklaruar si e ardhur në deklarin periodik të vitit 2016 dhe as në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 për gjendjen në llogarinë rrjedhëse në “Intesa SanPaolo Bank”, përputhet me dokumentacionin e bankës.
- ✓ Nisur nga dokumentacioni ligjor i të ardhurave nga burime të ligjshme, nga deklaratet e subjektit të rivlerësimit për shtesa në gjendje *cash*, ndryshime të vlerave monetare në bankë, si dhe nga informacioni për shpenzime të kryera për këtë vit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar si gjendje shumë e lënë në këtë llogari bankare, shtesën e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2015.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes së llogarisë bankare në shumën 8.057 lekë.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhurat e bashkëshortit në vlerën 42.500 lekë, përfituar me transfertën e datës 20.6.2016 në këtë bankë.

7. Llogari rrjedhëse në emër të bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”

Gjendja: 86.825,32 lekë (deri në datën 24.1.2017);

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga paga.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Nxjerrje llogarie, datë 24.1.2017, “Raiffeisen Bank”; gjendja e llogarisë së znj. L. S., në datën 24.1.2017 është 86.825 lekë.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresa nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare.

Arsyetimi ligjor

Nga përgjigjja prej “Raiffeisen Bank” rezulton se personi i lidhur ka disa llogari (page, rrjedhëse, depozitë) në lekë pranë kësaj banke, të hapur që prej vitit 2005.

Pas analizës financiare Komisioni konkludoi se:

- ✓ Gjendja në këtë llogari bankare konfirmohet se përputhet me dokumentacionin e dhënë nga “Raiffeisen Bank”.

- ✓ Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes së llogarisë bankare.

8. Depozitë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 4.944.512 lekë. Depozitë e krijuar prej vitit 1988 në “Bankën e Kursimeve”. Provuar me kontratën e depozitës me afat, të datës 24.1.2017. Në bashkëpronësi 50% me 50% nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin.

Gjendja: 4.944.512 lekë.

Burimi i deklaruar në “Vetting”: kursime familjare.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Kontratë depozite, datë 24.1.2017, “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. L.S.; shuma e investuar: 4.944.512 lekë;*
- *Kartelë depozite kursimi “Banka e Kursimeve” në emër të znj. L.S., për depozitime, vitet 2001 – 2006;*
- *Balancë + nxjerrje llogarie, datë 1.11.2016, “Raiffeisen Bank”, për lëvizjet e depozitës së znj. L.S., për vitet 2005 – 2016.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare.

Arsyetimi ligjor

Nga përgjigjja e marrë prej “Raiffeisen Bank” rezulton se personi i lidhur ka disa llogari (page, rrjedhëse, depozitë) në lekë pranë kësaj banke.

Kjo depozitë ka pasur këtë ecuri:

Viti	Gjendje në lekë në datën 31.12
2003	1305939
2004	1365531
2005	2666000
2006	2841823
2007	2846212
2008	3045984
2009	3268223
2010	4245001
2011	4483788
2012	4722529
2013	4905290
2014	4931780
2015	4944357
2016	4944662

Si burim për krijimin dhe shtimin e depozitës janë deklaruar kursimet familjare në deklaratën “Vetting” dhe në deklarinimin për herë të parë të subjektit të rivlerësimit.

Referuar deklarimeve të të ardhurave të bashkëshortit në deklaratën “Vetting”, rezultojnë këto të ardhura të deklaruara:

Përshkrimi	Periudha	Shuma e deklaruar
Punësimi në Këshillin e Rrethit Tepelenë	1.1.1994 – 3.9.1995	126199
Punësuar në FZSHH, paga dhe dëmshpërblimi për largimin nga puna	1.8.1995 – 31.3.2007	9148957
Punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k. (paga dieta dhe shpërblime)	2006 – deri gusht 2010	6600000
Punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k.	shtator 2010 – 2016	5433500
Punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k.	mars 2015 – shtator 2016	1351895

Në këto rrethana, Komisioni hetoi dhe analizoi dokumentacionin ligjor provues mbi të ardhurat nga subjektet punëdhënëse të personit të lidhur (Këshilli i Rrethit Tepelenë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k. dhe shoqëria “****” sh.p.k.), duke i krahasuar ato me dokumentacionin e sjellë nga subjekti i rivlerësimit. Përlllogaritja e të ardhurave nga burime të ligjshme është bërë në respektim të përcaktimeve të pikës 3 (fjalja e dytë), të nenit D, të ligjit nr. 76/2016 (Aneksi i Kushtetutës), sipas së cilit: *“Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*.

Këshilli i Rrethit Tepelenë:

Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara nga punësimi në Këshillin e Rrethit Tepelenë, në vlerën prej 126.199 lekësh, për periudhën 1.1.1994 – 7.9.1995, është dorëzuar një vërtetim për bazën e vlerësueshme të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit:

Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me shkresat e datës 27.10.2016, janë paraqitur përkatësisht pesë formularë vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën 4.9.1995 – 31.3.2007, me të ardhura nga paga, në vlerë totale *neto* prej 8.659.031 lekësh, si dhe vërtetimi për pagesë shpërblimi (për largim nga puna) në vlerë *neto* prej 489.928 lekësh.

Shoqëria “****” sh.p.k.:

Nga shoqëria “****” sh.p.k., është paraqitur vërtetimi i datës 27.11.2014, në të cilën evidentohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me profesionin inxhinier gjeodet, për vitin 2006 ka punuar me kohë të pjesshme në këtë kompani; detyra e tij ka qenë kryerja e punimeve topografike dhe e zbatimit. Për punën e kryer është shpërblyer me vlerën prej 1.100.000 lekësh (nuk ka të dhëna për shlyerjen e detyrimeve të tatimit në burim për të ardhurat). Referuar këtij vërtetimi, prej vitit 2007 e deri në gusht 2010, ka punuar me kohë të plotë në detyrën e drejtuesit teknik dhe është paguar në shumën totale prej 5.500.000 lekësh.

Por, referuar bilancit kontabël të shoqërisë “****” sh.p.k. për vitin 2007 (të dhënat *online* të QKB-së), rezulton se në pasqyrën “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave” nuk ka të përfshirë punonjës me arsim të lartë, teknikë dhe nëpunës të thjeshtë (deklarohen vetëm drejtues, pronarë dhe

punëtorë). Gjithashtu, referuar kësaj pasqyre, si dhe pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2007 të kësaj shoqërie, nuk evidentohen fonde të dhëna për shpërblime ndaj punonjësve.

Referuar kontratës së punës së datës 9.5.2008, shoqëria “****” sh.p.k, në cilësinë e punëdhënësit, ka lidhur marrëdhënie punësimi me personin e lidhur për një periudhë 2-vjeçare, duke filluar nga data 1.5.2008, me pagë mujore 50.000 lekë dhe shpenzime të tjera që do të paguheshin në fund të çdo muaji. Referuar kësaj kontrate, të ardhurat nga paga për periudhën 1.5.2008 – 1.5.2010, rezultojnë në shumën totale prej 1.200.000 lekësh.

Nga shoqëria “****” sh.p.k. në llogarinë në “Alpha Bank” të personit të lidhur janë transferuar pagat, konkretisht për periudhën shtator 2008 – korrik 2010, në shumën 832.128 lekë.

Nga të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier rezulton se për periudhën 1.4.2007 – 31.7.2009, shoqëria “****” sh.p.k. ka deklaruar pranë këtij institucioni punësimin e personit të lidhur me pagat *bruto* shumë më të ulëta sesa vërtetimi i lëshuar për deklaratën “Vetting”. Ndërsa nga të dhënat e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj për periudhën 2006 – 2008 nga shoqëria “****” sh.p.k., në zërin “dieta”, është deklaruar në total për të gjithë punonjësit shuma 204.000 lekë, duke shtuar dyshimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, se bashkëshorti i saj ka përfituar për këtë periudhë shpërblime dhe dieta me lekë në dorë (*cash*) nga arka e shoqërisë “****” sh.p.k.

Pra, rezultojnë mospërputhje mes vërtetimit të shoqërisë “****” sh.p.k. të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, me të dhënat nga burimet zyrtare në shumën 4.942.207 lekë më pak.

Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, krahasuar me ato të vërtetuara, për të cilat janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore, rezultojnë këto diferenca:

Vitet	Të ardhura të deklaruara në lekë	Të ardhura <i>neto</i> të vërtetuara për të cilat janë shlyer detyrimet në lekë
2006	1100000	0
2007	1500000	360745
2008	1500000	453888
2009	1500000	540568
2010	1000000	302592
Total	6600000	1657793

Shoqëria “****” sh.p.k.:

Nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin e datës 4.12.2014, sipas të cilit personi i lidhur, prej muajit shtator 2010 e në vazhdim është i punësuar pranë kësaj shoqërie me detyrën e drejtuesit teknik. Në kontratën e punës është përcaktuar kohëzgjatja e punësimit për 5 vjet, dhe se për punën e kryer në periudhën shtator 2010 – dhjetor 2013 është paguar në total 4.578.000 lekë.

Referuar kontratës së punës datë 9.11.2010, paga mujore e personit të lidhur do të jetë 190.000 lekë (për periudhën 5-vjeçare), ndërsa sipas kontratës së punës datë 17.9.2015, afati është 5 vjet dhe fillon në datë 1.9.2015 deri në datën 1.9.2020, dhe paga mujore e përcaktuar është 50.000 lekë.

Nga ISSH-ja, rezulton se, për periudhën janar 2012 deri në dhjetor 2014 personi i lidhur është punëmarrës tek shoqëria “****” sh.p.k., por me pagë bruto 48.000 lekë (muaji janar) dhe për periudhën në vazhdim me pagë bruto 40.000 lekë/muaj.

Paga bruto për vitin 2012 rezulton 488.000 lekë, për vitin 2013 në shumën bruto 480.000 lekë, në vitin 2014 për shumën bruto 480.000 lekë (pa muajin nëntor 2014), për vitin 2015 në shumën bruto 480.000 lekë dhe për vitin 2016 në shumën bruto 480.000 lekë.

Pra, rezultojnë mospërputhje mes vërtetimit të shoqërisë “****” sh.p.k., të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, me të dhënat nga burimet zyrtare, në shumën 2.649.148 lekë më pak.

Vitet	Të ardhura të deklaruara në lekë	Të ardhura neto të vërtetuara për të cilat janë shlyer detyrimet në lekë
2010	600000	600000
2011	1800000	566064
2012	1800000	353024
2013	378000	409760
2014	410640	342200
2015	410640	479080
2016	68440	68444
Total	5467720	2818572

Shoqëria “****” sh.p.k.:

Duke filluar nga muaji mars 2015 janë deklaruar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore edhe pagat bruto nga shoqëria “****” sh.p.k. Për vitin 2015 të ardhurat bruto të deklaruara nga kjo shoqëri janë 604.091 lekë dhe për vitin 2016 janë 1.100.000 lekë.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Gjirokastër, janë dërguar të dhëna të deklaruara nga shoqëria “****” sh.p.k. në lidhje me të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur për periudhën shtator 2010 – qershor 2017, në shumën neto totale prej: 1.610.113 lekësh.

Nga analiza të ardhurave për periudhën 1994 – 2016, bazuar në dokumentacionin e siguruar nga burime zyrtare, konstatohen të ardhura në shumën 15.103.416 lekë, krahasuar të ardhurave në shumën 22.694.771 lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga shoqëritë tregtare në kuadër të deklaratës “Vetting”.

Edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor bankar dhe kontabël formën dhe kalimin e këtyre të ardhurave, si dhe nuk vërtetoi me dokumentacion ligjor shlyerjen e detyrimeve tatimore për këto të ardhura personale.

Më konkretisht, situata pasqyrohet në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Përshkrimi	Periudha	Shuma e deklaruar	Shuma e vërtetuar
Punësimi në Këshillin e Rrethit Tepelenë	1.1.1994 – 3.9.1995	126199	126199
Punësuar në FZSHH, paga dhe dëmshpërblimi për largimin nga puna	1.8.1995 – 31.3.2007	9148957	9148957
Punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k. (paga dieta dhe shpërblime)	2006 – gusht 2010	6600000	1657793
Punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k.	shtator 2010 – 2016	5467720	2818572
Punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k.	mars 2015 – shtator 2016	1351895	1351895
Totali		22694771	15103416

Pas analizës financiare Komisioni konkludoi se:

- ✓ Gjendja në këtë llogari bankare përputhet me dokumentacionin nga “Raiffeisen Bank”.
- ✓ Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, nga paga, shpërblimet dhe dietat gjatë punës së tij pranë shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., sipas shkresave të këtyre të fundit, nuk përputhen me të ardhurat e rezultuara në dokumentacionin zyrtar të siguruar gjatë hetimit administrativ.
- ✓ Nga analiza e dokumentacionit zyrtar të siguruar gjatë hetimit administrativ rezulton se personi i lidhur ka përfituar 7.591.355 lekë më pak nga sa ka deklaruar në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit (nga shoqëria “****” sh.p.k ka përfituar 4.942.207 lekë më pak, ndërsa nga shoqëria “****” sh.p.k. ka përfituar 2.649.148 lekë më pak).
- ✓ Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme (nga puna e bashkëshortit në periudhën 1994 – 2016) në shumën 7.591.355 lekë, për krijimin e gjendjes së llogarisë bankare.

9. Depozitë te BKT-ja në vlerën prej 4.200.000 lekësh

Në bashkëpronësi 50% me 50% nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin.

Gjendja: 4.200.000 lekë;

Burimi i deklaruar në deklaratën “Vetting”: kursime familjare.

10. Gjendje cash në vlerën prej 1.200.000 lekësh

Në bashkëpronësi 50% me 50% nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin.

Gjendja: 1.200.000 lekë.

Burimi i deklaruar në deklaratën “Vetting”: kursime familjare.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Kontratë llogarie kursimi, datë 25.1.2017, midis BKT-së dhe znj. Albina Spaha dhe mandat derdhjeje cash të shumës prej 4.200.000 lekësh.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresa nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera për shërbime financiare.

Arsyetimi ligjor

Nga përgjigja e BKT-së rezulton se në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në këtë bankë shumën prej 4.200.000 lekësh.

Subjekti i rivlerësimit ka filluar të deklarojë kursime në *cash* në deklarin periodik të vitit 2005. Në fund të vitit 2016 gjendja e kursyer arrin shumën prej 5.829.560 lekësh (referuar deklarimeve periodike), deklarime këto të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Viti	Gjendja e deklaruar (në lekë)	Shtesa /pakësime të deklaruara (në lekë)	Gjendje pas ndryshimeve 31/12 (në lekë)
2003	0	0	0
2004	0	0	0
2005	0	700000	700000
2006	0	2300000	3000000
2007	0	-1500000	1500000
2008	0	1300000	2800000
2009	0	1500000	4300000
2010	0	600000	4900000
2011	0	-211440	4688560
2012	0	2620000	7308560
2013	0	274000	7582560
2014	0	620000	8202560
2015	0	290000	8492560
2016	0	-2663000	5829560

Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaron se në janar 2017 ka pasur gjendje *cash* shumën prej 1.200.000 lekësh, si dhe një depozitë në BKT në shumën prej 4.200.000 lekësh, të krijuar në datë 25.01.2017, nga një depozitim *cash*. Pra, rezulton mospërputhje në gjendjet në fund të vitit 2016, në vlerën prej 429.560 lekësh më pak ($5.829.560 - 4.200.000 - 1.200.000 = 429.560$). Pasqyrimi i mësipërm i gjendjeve *cash* është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, e cila pretendon që:

“Në analizën për shtesat dhe pakësimet e kursimeve trajtohet gabim viti 2007. Në këtë vit kam deklaruar:

- shtesë kursimesh:	2.000.000 lekë
- sakësim kursimesh për pagesë apartamenti:	<u>-4.558.000 lekë</u>
- TOTALI:	-2.558.000 lekë

Pra, në total ka pasur një ulje të kursimeve në shumën 2.558.000 lekë dhe jo 1.500.000 lekë siç keni pasqyruar në tabelë.

Gjithashtu, për vitin 2011 kam deklaruar shtesë kursimesh 900.000 lekë dhe pakësim për blerje automjeti 1.100.000 lekë (8.000 €). Diferenca neto është -200.000 lekë dhe jo 211.440 sikurse është pasqyruar në tabelën tuaj.”

Për sa më sipër, Komisioni mori në konsideratë deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2007, në të cilën nuk rezulton që të jetë deklaruar shtesë kursimi për këtë vit dhe as kthimi i huas së dhënë motrës së bashkëshortit në vlerën prej 500.000 lekësh. Ndërsa për vitin 2011, kursimet *cash* në banesë janë shtuar me 900.000 lekë dhe janë pakësuar me 8000 euro. Në fund të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka gjendje *cash* 211.440 lekë më pak se në fund të vitit 2010 (+900.000 lekë – 1.111.440 lekë). Në mënyrë më të detajuar, situata pasqyrohet në tabelën krahasuese të gjendjeve *cash* të deklaruara, si më poshtë:

Viti	Subjekti pas rezultateve të hetimit		Komisioni për analizë	
	Shtesa / pakësime të deklaruara	Gjendja pas ndryshimeve 31/12	Shtesa / pakësime të deklaruara	Gjendja pas ndryshimeve 31/12
2003	0	0	0	0
2004	0	0	0	0
2005	700000	700000	700000	700000
2006	2300000	3000000	2300000	3000000
2007	-2058000	942000	-1500000	1500000
2008	1300000	2242000	1300000	2800000
2009	1500000	3742000	1500000	4300000
2010	600000	4342000	600000	4900000
2011	-200000	4142000	-211440	4688560
2012	2620000	6762000	2620000	7308560
2013	274000	7036000	274000	7582560
2014	620000	7656000	620000	8202560
2015	290000	7946000	290000	8492560
2016	-2663000	5283000	-2663000	5829560

Për periudhën 2005-2016 (periudhë e deklarimeve të gjendjeve *cash*), duke marrë në konsideratë të ardhurat e vërtetuara të familjes së subjektit të rivlerësimit, shpenzimet për transport të deklaruara, shpenzimet jetike referuar raportit të ILDKPKI-së, vlerat monetare në bankë referuar dokumentacionit përkatës, si dhe vlerat monetare *cash* shtesa/pakësime dhe gjendje në banesë, në fillim dhe në fund të periudhës, sipas deklarimeve dhe shpjegimeve në përgjigje të pyetësorëve (përfshirë dhe reduktimet për sa i përket transportit dhe shpenzimeve të karburantit të deklaruara), **rezultojnë një balancë negative e fondeve në shumën prej 5.896.320 lekësh** (me përjashtim të viteve 2011 dhe 2016 në të cilat rezulton balancë pozitive e fondeve).

Referojuni tabelës sa më poshtë:

Datë 31/12	Balanca e fondeve
2005	-1036229
2006	-665994
2007	-835989
2008	-526875
2009	-602677

2010	-652631
2012	-1066875
2013	-346495
2014	-154498
2015	-8057

Pas analizës financiare Komisioni konkludoi:

- ✓ Depozita bankare në emër të subjektit të rivlerësimit përputhet me të dhënat e “Bankës Kombëtare Tregtare”.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme (me burim të deklaruar “shtesa të gjendjeve cash për periudhën 2005–2015”) për krijimin e depozitës në BKT në shumën prej 4.200.000 lekësh dhe gjendjes së likuiditeteve cash në banesë në shumën prej 1.200.000 lekësh.
- ✓ Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative të fondeve në shumën prej 5.896.320 lekësh.

11. Pasuri e paluajtshme tokë bujqësore me sip. 2.2 dynym në emër të z. M.S., e përfituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”, me aktin nr. *** të marrjes së tokës në pronësi. Nuk rezulton të jetë e regjistruar pasi nuk i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, provuar ky fakt me vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2016, të ZVRPP-së Tepelenë.

- 25 % në bashkëpronësi të familjes bujqësore prej 4 anëtarësh.

Vlera: nuk deklarohet vlerë.

Burimi: nga zbatimi i ligjit nr. 7501 me aktin nr. *** të marrjes së tokës në pronësi.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, të Bashkisë Tepelenë, me anë të të cilit vërtetohet se z. M.S., bashkëshortja e tij dhe djali, Sh.S., kanë banuar dhe banojnë në fshatin Bënçë.*
- *Vërtetim datë 20.10.2016 i kryetarit të fshatit Bënçë, me anë të të cilit vërtetohet se z. M.S., bashkëshortja e tij dhe djali, Sh.S., kanë banuar dhe banojnë në fshatin Bënçë.*
- *Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, i ZVRPP-së Tepelenë, sipas të cilit z. M.S., banor i fshatit Bënçë, nuk ka të regjistruar pasuri të paluajtshme tokë bujqësore apo truall në fshatin Bënçë, pasi ky fshat nuk i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar.*
- *Vërtetim datë 25.1.2017 i OSHEE-së Gjirokastër, sipas të cilit z. M.S., ka kontratën nr. *** si banues në fshatin Bënçë dhe librezë të pagesave.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Shkresë nr. *** prot., datë 6.12.2018, drejtuar Bashkisë Tepelenë;
- Shkresë nr. *** prot., datë 6.12.2018, drejtuar Këshillit të Qarkut Gjirokastër (DMAT).

Arsyetimi ligjor

Personi i lidhur ka dorëzuar në ILDKPKI aktin nr. *** të datës 28.2.1994 të marrjes së tokës në pronësi, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Bënçë, të rrethit Tepelenë, për dy ngastra.

Nga Drejtoria e Administrimit dhe Mirëmbajtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë konfirmohet fakti se anëtarët e familjes së origjinës së personit të lidhur janë trajtuar me tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, përkatësisht:

L.S.	550 m ²
M.S.	550 m ²
Sh.S.	1.300 m ²
Totali:	2.400 m²

Kjo pasuri nuk është e regjistruar në ZVRPP-në Tepelenë, pasi nuk ka nisur ende regjistrimi fillestar i pasurive në fshatin Bënçë, fakt i konfirmuar nga ZVRPP-ja dhe nga Bashkia e këtij qyteti.

Ky aset deklarohet për herë të parë nga personi i lidhur në deklaratën “Vetting” 2017, ndonëse rezulton se është trajtuar me tokë sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”, datë 19.7.1991, në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi që në vitin 1994.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar *se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë jetuar në fshat pas martesë dhe nuk e kanë përdorur apo përfituar të ardhura nga kjo pasuri, pra, mospasqyrimi në deklaratat periodike nuk ka pasur qëllim fshehjen apo për ndonjë arsye tjetër specifike.*

Pavarësisht nga shpjegimi i mësipërm, Komisioni mban në konsideratë detyrimet e përcaktuara sipas gremës “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive...: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Përfitimi i tokës bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, nga personi i lidhur (si anëtar i familjes bujqësore me kryefamiljar babanë e tij) përputhet me të dhënat e DAMT-it të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.
- ✓ Deklarimi i pasurive në deklaratën “Vetting” 2017 nuk përputhet me deklarinimet e pasurisë së personit të lidhur në deklaratat periodike të viteve 2003 – 2016, pasi nuk ka deklaruar të plotë gjendjen tij pasurore në vitin 2003 dhe ndryshimet ndër vite, si dhe ka dhënë deklarinim të pasaktë mbi sasinë e tokës që ka përfituar.

12. Shtëpi banimi njëkatëshe në fshatin Bënçë, Tepelenë, ndërtuar para viteve 1990, e paregjistruar

Në këtë banesë banon z. M.S, znj. T.S., së bashku familjen e djalit, z. Sh.S.

Sipërfaqe: nuk deklarohet sipërfaqe;

Vlera: nuk deklarohet vlerë;

Burimi: nuk deklarohet burim.

Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- *Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Bashkia Tepelenë, me anë të të cilit vërtetohet se z. M.S., bashkëshortja e tij dhe djali, Sh.S, kanë banuar dhe banojnë në fshatin Bënçë.*
- *Vërtetim datë 20.10.2016 i kryetarit të fshatit Bënçë, me anë të të cilit vërtetohet se z. M. S, bashkëshortja e tij dhe djali, Sh.S., kanë banuar dhe banojnë në fshatin Bënçë.*
- *Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016 i ZVRPP-së Tepelenë, sipas të cilit z. M.S., banor i fshatit Bënçë nuk ka të regjistruar pasuri të paluajtshme tokë bujqësore, apo truall në fshatin Bënçë pasi ky fshat nuk i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar.*
- *Vërtetim, datë 25.1.2017, nga OSHEE-ja Gjirokastër, sipas të cilit z. M.S., ka kontratë me nr. ***, banues në fshatin Bënçë dhe librezë të pagesave.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave Informale;
- Shkresë nr. *** prot., datë 6.12.2018, drejtuar ALUIZNI-t Gjirokastër;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme;
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Tepelenë” sh.a.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Arsyetimi ligjor

Mbi faktin e ekzistencës së kësaj shtëpie banimi janë shprehur Bashkia Tepelenë dhe kryetari i fshatit Bënçë. Por, në ZVRPP-në Tepelenë nuk rezulton asnjë pasuri e regjistruar në emrin e bashkëshortit dhe të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit (vjeherri, vjehrra, kunati).

Nga ALUIZNI Gjirokastër, që ka në juridiksion edhe rrethin e Tepelenës, vjen përgjigje negative dhe bëhet e ditur se nuk rezultojnë të regjistruara kërkesa për legalizim objekti informal.

Nga OSHEE sh.a. konfirmohet se në emër të vjeherit të subjektit të rivlerësimit ka një kontratë për furnizim me energji elektrike, me datë hapjeje 31.12.2008. Nuk përcaktohet nëse i referohet shtëpisë së tij në Bënçë.

Nga Ujësjetës Kanalizime Tepelenë nuk rezultojnë kontrata për këtë shtëpi.

Për sa më sipër Komisioni kërkoi sqarime nga subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, e cila deklaroi se *sipërfaqja e banesës është 105 m², sipas matjeve të kryera nga personi i lidhur/bashkëshorti, në mungesë të ndonjë dokumentacioni të formalizuar në lidhje me sipërfaqen. Vlera e ndërtimit nuk mund të përcaktohet, pasi 1/2 e shtëpisë është ndërtuar në vitet 1963-1965, ndërsa pjesa tjetër është ndërtuar në vitet 1978-1981, nga prindërit e bashkëshortit. Ai ka jetuar në këtë banesë deri në vitin 1996.*

Për vlerësimin e këtij aseti, Komisioni ka në vëmendje dy dispozita ligjore, në bazë të të cilave realizon procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht:

➤ pikën 11, të nenit 3 (përkufizime), të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:
“11. “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”.

➤ germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit:
“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive...: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”.

Nga sa më sipër, rezulton se në deklaratën “Vetting” 2017, subjekti i rivlerësimit ka përfshirë në deklaram pasuri që nuk i përkasin asaj dhe as personit të lidhur.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

✓ Ky aset nuk përbën objekt vlerësimi të kriterit të pasurisë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

GJETJE TË KOMISIONIT GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

Komisioni ka konstatuar se në datën 26.6.2016, në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Intesa Sanpaolo Bank”, ka kaluar pagesa prej 42.000 lekësh nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me përshkrimin si pagesë për një ekspertizë të kryer në një proces pranë kësaj gjykate.

Ky aktivitet dhe kjo pagesë nuk rezultojnë të jenë pasqyruar në deklaratën “Vetting” 2017 (as si aktivitet dhe as si burim i të ardhurave), çka shtyu Komisionin të thellojë hetimin administrativ, për të konstatuar saktësisht periudhën kohore dhe pozicionin specifik që ka qenë i angazhuar personi i lidhur, si dhe përfshirjen apo mbështetjen nga ana e subjektit të rivlerësimit në realizimin e aktivitetit si ekspert topograf-gjeoded, pa qenë i regjistruar në organet tatimore si subjekt tatimpagues, si dhe pa qenë i regjistruar si ekspert në listën e të gjitha gjykatave që përfshihen në territorin e juridiksionit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë (duke përfshirë edhe GJASHP-në Gjirokastrë).

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se mosdeklarimi nuk është i qëllimshëm, pasi nuk ishte informuar nga bashkëshorti mbi këtë të ardhur.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë), si dhe nga të dhënat e aksesueshme në sistemin elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, konstatohet se këto gjykata kanë publikuar listat e ekspertëve, bazuar në përmbushje të detyrimit për hartimin dhe publikimin e listave të ekspertëve të fushave të ndryshme të teknikës, shkencës dhe artit, si dhe të detyrimit për përditësimin e kësaj liste vit pas viti. Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, lista e ekspertëve të gjykatës nuk kishte asnjë emër të shënuar.

Detyrimi i hartimit dhe i publikimit të listave të ekspertëve të gjykatës buron nga udhëzimi nr. 4, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave. Sipas këtij udhëzimi, disiplinohet mënyra e përzgjedhjes së ekspertëve rast pas rasti nga gjykata, e cila duhet që të shterojë fillimisht thirrjen në gjykim të ekspertëve nga lista e bërë publike. Në raste të jashtëzakonshme (kur asnjë ekspert nga lista nuk është i disponueshëm ose kur në listë nuk ka ekspertë të llojit që i nevojitet gjykimit), gjykata mund të kërkojë a të thërrasë ekspertë të jashtëm.

Aktualisht, mënyra e hartimit dhe e publikimit të listës së ekspertëve të gjykatës rregullohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (neni 224/d, KPC) dhe të Kodit të Procedurës Penale (neni 179, KPP), edhe pas ndryshimeve që iu bënë këtyre kodeve në vitin 2017. Listat përgatiten nga Ministria e Ministria e Drejtësisë, e cila ua përcjell në formë elektronike gjykatave.

Sa i takon mënyrës së caktimit të shpërblimit të ekspertëve, mënyrës së pagesës së shpërblimit, si dhe problematikave të tjera mbi shpenzimet gjyqësore për shkak të ekspertizave, udhëzimi nr. 4, datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave, bën një rregullim të detajuar, duke vendosur si kriter kryesor që ekspertët të jenë të licencuar (me licencë profesionale), si dhe të jenë subjekte tatimpagues (rregullat e caktimit të shpenzimeve dhe të pagesës së ekspertit përcaktohen në kreun II të udhëzimit), sipas të cilit, pagesa për ekspertin nuk mund të kalojë shumë më 40.000 lekë, në të cilën shtohen pagesa për shpenzime transporti, dietë, fjetje, për shkak të largësisë së tij me gjykatën ku do të bëjë ekspertimin, duke e vërtetuar këtë me dokumentin tatimor përkatës në përputhje me legjislacionin për procedurat tatimore.

Nga të dhënat e siguruar nga gjykatat e mësipërme, listën e ekspertëve e kanë bërë publike vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk ka bërë publike asnjë listë ekspertësh, duke shkaktuar një situatë të pandërprerë në shkelje ligjore.

Duke u rikthyer në këtë hetim, konstatohet se emri i personit të lidhur është shënuar vetëm në listën e ekspertëve lokalë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë (nr. *** në listë).

Në këto rrethana, Komisioni i drejtoi subjektit të rivlerësimit dy pyetësorë të veçantë (*pyetësori 4* dhe *pyetësori 5*) që kishin të bënin me mënyrën e hartimit dhe të publikimit të listës së ekspertëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, personin përgjegjës për hartimin e kësaj liste, mënyrën

e përzgjedhjes dhe të thirrjes së tyre nga ana e gjykatës (kupto: nga trupat gjykuese, sipas nevojave të çështjeve në gjykim), përcaktimin e shumës së pagesës së shpërblimit të ekspertëve dhe mënyrës së kryerjes së kësaj pagese, si dhe, në fund (por jo për nga rëndësia), nivelin ligjor të vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ligjore të kryetarit të gjykatës, në lidhje me administrimin e çështjeve të mësipërme.

Subjekti i rivlerësimit, për sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur shpjegoi se:

- *Hartimi dhe përditësimi i listës së ekspertëve është detyrë e kancelarit të gjykatës.*
- *Thirrja e ekspertëve në gjykatë dhe përzgjedhja e tyre (me emër) është bërë nga trupi gjykues bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale, pas marrjes së mendimit të palëve ndërgjyqëse (të cilave, sipas mendimit të subjektit të rivlerësimit, ligji u ka dhënë rol aktiv). Janë po trupat gjykuese që përcaktojnë edhe masën e shpërblimit si dhe palën që ngarkohet me detyrimin e likuidimit (sipas nenit 105 të Kodit të Procedurës Civile).*
- *Gjykata disponon buxhet vjetor të posaçëm të miratuar nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, për shpenzimet gjyqësore (kodi/llogaria nr. 602) që mbulon edhe pagesat për ekspertizat, në bazë të treguesve të vitit pararendës, me mundësi rishikimi apo rialokimi. Nga struktura e financës dhe me ciklimin e kryetarit të gjykatës kryhet pagesa për ekspertët nëpërmjet bankës. Kryetari i gjykatës nuk ka rol aktiv, por formal në këtë procedurë.*
- *Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka marrë pjesë në disa çështje gjyqësore (në të gjitha gjykatat e sipërcituara, përfshi edhe gjykatën ku ajo vetë është kryetare). Në të gjitha rastet është thirrur nga trupi gjykues në mënyrë të pavarur dhe vetëm pasi palët kanë qenë dakord që ai të ishte ekspert në gjykimin përkatës. Për punën e kryer ka përfutur shpërblim nëpërmjet gjykatës, ose nëpërmjet ekspertit koleg, që merrte pjesë në ekspertim bashkë me të (edhe ky i thirrur nga gjykata).*
- *Bashkëshorti i saj nuk është i regjistruar në organet tatimore, sepse ai është i punësuar dhe ekspertimin nuk e ka si aktivitet të vazhdueshëm (subjekti i rivlerësimit shprehet se ekspertizat janë sporadike, pra, pagesat për këto ekspertiza nuk janë burim i rregullt i të ardhurave, sepse janë rast pas rasti sipas kërkesës së gjykatës, si dhe angazhimi në punë me kohë të plotë nuk i jep mundësinë për t'u shkëputur për qëllime ekspertimi). Për pasojë, për shërbimet e tij ai nuk ka lëshuar faturë tatimore për pagesat mbi shërbimet e tij si ekspert në gjykatë.*
- *Gjithashtu nga subjekti i rivlerësimit pretendohet se bashkëshorti i saj nuk mund të regjistrohet si subjekt tatimpagues, sepse cilësia e ekspertit nuk e bën atë subjekt tregtar që ushtron aktivitet në një ambient ku publiku ka akses, bazuar në parimet e konkurrencës dhe të nismës së lirë, duke mbartur edhe rrishtun e dështimit. Ndërsa, sa i takon detyrimeve fiskale që lidhen me pagesat për ekspertizat, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ato janë likuiduar nga ana e ekspertëve të tjerë që kanë marrë pjesë në proces, të cilët kanë mbuluar me faturim të gjithë vlerën e ekspertimit, duke i dorëzuar bashkëshortit vetëm pagesën neto për pjesën e tij takuese nga realizimi i ekspertizës, që rezulton pas mbajtjes nga shuma e faturuar të tatimit përkatës.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka dhënë mendimin e vet, si këndvështrim mbi pozitën e bashkëshortit të saj në raport me detyrimet e parashikuara në legjislacionin fiskal, duke qenë se për çdo rast faturimi kryhet nga një tjetër subjekt tatimpagues, duke qëndruar në*

pozitat se nuk krijohen rrethanat e evazionit fiskal (shmangia nga detyrimet tatimore), si dhe as shkelje të tjera të natyrës së kundërvajtjes administrative, për sa kohë që të ardhurat nga ekspertizat nuk e kalojnë pragun minimal të të ardhurave, për të cilat ligjvënësi ka parashikuar detyrime fiskale në masën “zero” lekë, si dhe nga ana tjetër, transaksioni është i pasqyruar në dokumentacion tatimor. Subjekti i rivlerësimit e mbështet qëndrimin e saj në dispozitat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe te udhëzimi nr.5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ministrit të Financave, si dhe te ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH.”.

Nga informacioni i dhënë nga gjykatat dhe nga subjekti i rivlerësimit, pjesëmarrja e personit të lidhur në ekspertiza të natyrës topografike është relativisht e shpeshtë në gjykata. Nga një vështrim paraprak u konstatuan disa raste të përfshirjes së personit të lidhur në ekspertiza të caktuara nga trupa gjyquese të ndryshme, në harkun kohor 2016 – 2018. Caktimi i tij si ekspert është bërë me vendim të ndërmjetëm të gjyqtarit të çështjes. Nga përmbajtja e vendimeve nuk rezulton burimi i informacionit për trupën gjyquese mbi aftësitë profesionale të personit të lidhur. Në disa raste, në çështjet ku është thirrur si ekspert topograf, pjesë e grupit të ekspertëve ka qenë dhe një ekspert i një lloji tjetër në fushën e pasurive të paluajtshme, por në vendimin e ndërmjetëm nuk rezulton që gjykata të ketë caktuar detyra që dalin jashtë sferës së topografisë. Pagesat për ekspertizat kanë variuar mes shumave 40.000 – 200.000 lekë, të cilat janë ngarkuar si detyrim te palët ndërgjyqëse, kryesisht te paditësit dhe/ose te ndërhyrësit kryesorë, të cilët kanë likuiduar shumën tek eksperti me licencë tatimore. Në një rast, pagesa është bërë nga paditësi në llogarinë e gjykatës dhe nëpërmjet kësaj të fundit është bërë kalimi në llogarinë e personit të lidhur si ekspert. Në një rast të përsëritjes së hetimit, pas kthimit për rigjykim të çështjes, pagesa ka qenë më e ulët se 40.000 lekë.

Në vlerësimin e situatës së mësipërme, Komisioni ka në vëmendje rregullimin ligjor me natyrë fiskale, të pasqyruar në këto akte ligjore:

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), nenet 5, 6 dhe 8;

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), neni 2;

Ligji nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), nenet 2, 3, 4, 5, dhe 11.

Komisioni konstaton se qasja apo qëndrimi juridik i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket ushtrimit të aktivitetit si ekspert topograf nga personi i lidhur, në kuadër të proceseve gjyqësore, bie në kundërshtim me disa dispozita ligjore që rregullojnë në mënyrë disiplinuese raportin mes institucionit që kërkon një punë ose një shërbim nga subjekte jashtë organikës dhe subjekteve që ofrojnë punën ose shërbimin e kërkuar, si dhe të prezantimit formal të secilit prej këtyre.

Pra, bëhet fjalë për interpretim të kundërt me logjikën e dhënë në paketën ligjore fiskale, në të cilën mënyra e pjesëmarrjes së personit të lidhur si ekspert pa një licencë tatimore (i shoqëruar ose jo nga një ekspert tjetër me licencë tatimore) mund të ndodhë vetëm në këto rrethana:

i. eksperti faturues ka punësuar personin e lidhur, të cilin e paguan mbi bazën e ekspertizave që realizohen prej tij, si porosi/urdhër/udhëzim nga i pari (por jo të thirrur drejtpërdrejt nga ana e gjykatës) dhe, në këtë rast, personi i lidhur, në organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duhej të figuronte si punëmarrës i ekspertit në fjalë;

ii. eksperti faturues e ka blerë shërbimin e personit të lidhur në bazë të një kontrate të rregullt, të cilin e paguan me çmim *neto* dhe, për shkak se nuk merr faturë nga shitësi (pra, nga personi i lidhur), shërben si agjent i shlyerjes së tatimit në burim.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Personi i lidhur ushtron aktivitet si ekspert topograf në gjykatë në shkelje të legjislacionit tatimor, pasi ka përfituar të ardhura nga ofrimi i shërbimit të ekspertizës topografike pa u regjistruar rregullisht në organet tatimore.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar të ardhurat nga ekspertizat në gjykatë gjatë vitit 2016.
- ✓ Si pasojë e qasjes personale të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit tatimor, ka rezultuar krijimi i situatave në shkelje të këtij legjislacioni dhe të kodeve procedurale, lidhur me mënyrën e dhënies së shërbimit të ekspertizës topografike në gjykatë nga personi i lidhur.

Konkluzione mbi vlerësimin e pasurisë

Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror për këtë subjekt rivlerësimi, konstaton se:

- ✓ *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. *** , datë 20.2.2018, të KDZH-së (bazuar në kërkesën e Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2018). Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Gjithashtu, pas verifikimit nga Komisioni, nuk janë gjetur indice për kontakte të subjektit të rivlerësimit apo të personit të lidhur që të ndikojnë në përshtatshmërinë ose jo për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Albina Spaha.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin:

1. e raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së, sipas shkresës nr. *** prot., datë 23.4.2018;
2. e vlerësimit të denoncimeve dhe vendimet gjyqësore të paraqitura në ankesat e subjekteve denoncuese;
3. e kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71).

I. Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Inspektorati i KLD-së është bazuar te:

- formulari i vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe tek të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, është nënshkruar në çdo fletë dhe është i rregullt nga pikëpamja formale. Subjekti nuk ka deklaruar adresë zyrtare.

b) Përvoja profesionale e dhjetë viteve të fundit

Subjekti ka deklaruar se në periudhën janar 2006 – qershor 2007 ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë; në periudhën korrik 2007 – tetor 2008 ka qenë gjyqtare në pritje emërimi në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; në periudhën nëntor 2008 – 2016 ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nga viti 2016 e aktualisht, kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

c) Detyrat e kryera tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në tri vitet e fundit ka ushtruar funksionin e gjyqtares, nuk ka pasur ndarje në trupa gjyqësore të caktuara apo në dhoma të veçanta sipas fushave (civile, penale, administrative apo familjare). Subjektit i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 1480 çështje gjyqësore në periudhën 2014 – 2016, nga të cilat ka trajtuar 1292 çështje dhe vitin e fundit të detyrës ka mbartur 55 çështje gjyqësore.

d) Trajnimet në tri vitet e fundit

Subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë ekspert në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 16 aktivitete trajnuese.

e) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit *vendim gjyqësor*. Një prej këtyre vendimeve ka qenë i vitit 2013 (jashtë periudhës së vlerësimit), një i vitit 2015 dhe një i vitit 2016.

Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

Subjekti i rivlerësimit ka të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ajo ka ushtruar në këtë periudhë.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 08.10.2013 – 08.10.2016, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 8 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (3 ankesa në vitin 2015 dhe 5 ankesa për vitin 2016). 6 ankesa (2 në vitin 2015, 4 të vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 2 ankesa me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa 4 ankesa të tjera me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura.

Dy ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- i. Një ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje, i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik në drejtim të zvarritjes së gjykimit dhe të mosrespektimit formal të ligjit. Konkretisht, është konstatuar se gjykimi i çështjes civile me objekt “pushim cenimi në pronësi dhe kthim sendi” e ka tejkaluar afatin standard 6-mujor të sistemit të vlerësimit, pasi deri në ditën e verifikimit çështja është gjykuar për një kohëzgjatje prej një viti, dy muajsh e katërbëdhjetë ditëve. Po ashtu, është konstatuar se gjyqtarja ka pasur parregullsi formale në zbatimin e ligjit në dhënien e vendimit të pezullimit të gjykimit, që ka ndikuar në ecurinë e gjykimit.
- ii. Një ankesë e vitit 2016 është në proces verifikimi për mosrespektim formal ligji dhe për zvarritje gjykimi.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Albina Spaha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga Komisioni, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” dhe kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, konstatohet si më poshtë:

1. Lidhur me aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit procedural dhe substancial. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti, znj. Albina Spaha, pasqyron njohuritë e saj mbi përgjegjësinë penale për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake në rrethana cilësuese apo për rrëmbim personi në bashkëpunim (shihni dokumentin 1 dhe dosjen 4), mbi servitutin e kalimit në pasuritë e paluajtshme (shihni dokumentin

2), mbi të drejtën e bashkëpronësisë në pasuritë e paluajtshme (shihni dokumentin 3), mbi vërtetimin gjyqësor të fakteve (shihni dosjen 1), mbi detyrimet kontraktore (shihni dosjen 2) dhe mbi masat e sigurimit në procedimin penal (shihni dosjen 3). Në një rast, subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, për zgjidhjen e çështjes ka përdorur dispozitat e kontratës së lidhur mes palëve (shihni dosjen 2), ndërsa në një çështje tjetër ka konstatuar natyrën e bardhë të normës penale dhe ka zbatuar për kuptimin e saj normat e Kodit Rrugor (shihni dosjen 3). I kushton rëndësi verifikimit të kompetencës lëndore dhe tokësore, duke disponuar nëse konstaton mungesë të tyre (shihni dokumentin 3 dhe dosjen 5).

Në vendimet gjyqësore nuk përdor rregullisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, ku rastet janë sporadike: parimi i një dyshimi të arsyeshëm e të bazuar në prova (shihni dosjen 3), parimin e gjësë së gjykuar (shihni dokumentin 3). Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ajo i referohet jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë (shihni dokumentet 1, 2 dhe 3, si dhe dosjen 5).

Ajo ka njohuri të dispozitave procedurale gjatë gjykimit, për çështjet gjyqësore rutinë që i paraqiten për shqyrtim. Në një rast, të kthyer nga Gjykata e Lartë për rigjykim, ajo ka reaguuar me vonesë në rigjykimin e çështjes për atë pjesë që kishte urdhëruar Gjykata e Lartë (ka dhënë dorëheqjen, e cila nuk është pranuar nga kryetari i Gjykatës dhe nuk ka kryer asnjë veprim me palët deri në plotësimin e trupit gjykues – shihni dosjen 4). Në tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur asnjë rast që gjykatat më të larta të kenë disponuar kthimin e çështjes së gjykuar prej saj për rigjykim në shkallë të parë. Janë konstatuar gjashtë vendime të ankimuara, nga të cilat katër vendime janë lënë në fuqi (shihni dokumentet 2 dhe 3, si dhe dosjet 1 dhe 3), ndërsa në dy raste të tjera vendimi është ndryshuar (shihni dokumentin 1 dhe dosjen 2). Arsyeja e cënimit të këtyre dy rasteve lidhet me vlerësimin e gabuar të provave dhe zbatimin e keq të ligjit material (shihni dosjen 2) dhe me ndryshimin e ligjit penal nga Gjykata Kushtetuese (shihni dokumentin 1).

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mjaftueshme në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare i arsyeton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve të subjektit është e qëndrueshme dhe unike dhe përmban elementet e kërkuara nga legjislacioni procedural; mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm. Pjesa arsyetuese e vendimit hartohet me tekst unik, me paragrafë të panumërtuar. Ajo përfshin në arsyetim edhe paragrafë standardë mbi çështje procedurale, që nuk janë kundërshtuar nga palët dhe që janë të zgjidhura nga praktika gjyqësore, siç janë çështjet e juridiksionit apo të kompetencës. I kushton rëndësi rregullave të drejtshkrimit, por nuk i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti i rivlerësimit nuk i kushton rëndësinë e duhur analizës së normës ligjore, e cila nuk është e plotë apo e saktë (shihni dosjet 1 dhe 2). Në një rast është konstatuar se përshkrimi i provave me dëshmitarë është i zgjeruar, gjë që rëndon tekstin e vendimit (shihni dokumentin 1). Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se vendoset për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit

për palët. Subjekti përdor referenca nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, por në dy raste nuk ka identifikuar saktësisht atributet e vendimeve gjyqësore të cilave iu referohet (shihni dokumentin 3 dhe dosjen 5). Përgjithësisht, niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat nuk mungon arsytimi dhe shkaku ligjor. Ndër pesë dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar asnjë rast që të ketë proceduar gjatë gjykimit, pa nxjerrë vendime të ndërmjetme.

2. Lidhur me aftësinë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, znj. Albina Spaha, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Lidhur me ngarkesën sasiore, ka deklaruar se tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar për gjykim rreth 1480 çështje, nga të cilat ka përfunduar 1292 çështje. Numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit është 55 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 87.2 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Albina Spaha ka përfunduar 1284 çështje, nga të cilat 617 çështje penale (228 krime dhe kundërvajtje, 87 çështje administrativo-penale dhe 302 masa sigurimi), 645 çështje civile të përgjithshme (346 me palë kundërshtare dhe 199 pa palë kundërshtare) dhe 122 çështje familjare. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka gjykuar 696 çështje gjyqësore sipas standardit sasior për tri vjet.

Sipas shkronjës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, i cili nuk është i organizuar në seksione si relator, duhet të gjykojë jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile me palë kundërshtare në vit. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh të tilla për tri vjet. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin sasior.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtaren Albina Spaha rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga data e marrjes së akteve me short, deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 1 ditë (shihni dosjen 3), ndërsa kohëzgjatja më e gjatë ka qenë 3 muaj e 21 ditë (shihni dosjen 4). Çështja, që ka pasur kohëzgjatjen më të gjatë të gjykimit prej 3 muaj e 21 ditësh, ka qenë çështje penale themeli dhe në përfundim është shprehur me vendim themeli. Në tri rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 2 muaj e 11 ditë (shihni dosjen 2), 1 muaj e 14 ditë (shihni dosjen 5) dhe 1 muaj e 15 ditë (shihni dosjen 1). Ndër pesë dosjet e vëzhguara, në asnjë rast nuk është konstatuar tejkalimi i afatit standard të gjykimit i vendosur nga KLD-ja.

Në tri dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor. Nga analiza e tri dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në të tria rastet brenda afatit standard të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht: 4 muaj e 19 ditë (shihni dokumentin 1), 5 muaj e 8 ditë (shihni dokumentin 2) dhe 4 muaj e 25 ditë (shihni dokumentin 3).

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtarja Albina Spaha i kushton rëndësi të veçantë arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për tri ditë nga shpallja (shihni dosjet 1 dhe 4), për një ditë nga shpallja (shihni dosjet 2 dhe 5) dhe brenda ditës (shihni dosjen 3). Ndër pesë dosjet e vëzhguara, asnjë vendim nuk është arsyetuar jashtë afatit ligjor.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, për gjyqtaren Albina Spaha janë paraqitur gjithsej tetë ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Nga shqyrtimi administrativ i tyre konstatohet se një ankesë është regjistruar për vlerësim profesional. Konkretisht, është konstatuar se gjykimi i çështjes civile me objekt “pushim cënimi në pronësi dhe kthim sendi” e ka tejkaluar afatin standard 6-mujor të Sistemit të Vlerësimit, pasi deri në ditën e verifikimit çështja është gjykuar për një kohëzgjatje prej 1 viti, 2 muajsh e 14 ditëve. Po ashtu, është konstatuar se gjyqtarja ka pasur parregullsi formale në zbatimin e ligjit në dhënien e vendimit të pezullimit të gjyqimit, gjë që ka ndikuar në ecurinë e gjyqimit. Gjithashtu, sipas këtyre të dhënave, një ankesë tjetër është ende në proces verifikimi për mosrespektim formal të ligjit dhe për zvarritje në gjykim (shihni: Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së).

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, duhet evidentuar se gjyqtarja Albina Spaha ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Ajo ka respektuar afatet standarde të gjyqimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesë vendimet gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, ku përgjithësisht seancat kanë qenë produktive. Ndër pesë dosjet e vëzhguara, një çështje është përfunduar me një seancë (shihni dosjen 3), dy çështje kanë përfunduar me tri seanca (shihni dosjet 1 dhe 5), ndërsa dy çështje të tjera kanë përfunduar me nga 6 seanca (shihni dosjet 2 dhe 4). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 19 seanca të zhvilluara prej subjektit, ndër të cilat 12 kanë qenë produktive. Pengesë në 7 seanca joproductive janë bërë njoftimi i parregullt i paditësit (1 seancë), mungesa e gjyqtarës për arsye shëndetësore (4 seanca), kërkesa e prokurorit për t'u njohur me aktet, e shkaktuar edhe nga koha e shkurtër e njoftimit prej gjykatës (1 seancë) dhe kërkesa e prokurorit për t'u konsultuar me prokurorin e rrethit (1 seancë). Konstatohet se zhvillon procedurat në mënyrë korrekte gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, ndjek hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve të pranishme dhe shkaqet e mungesës sipas rastit, komunikimin e të drejtave procedurale te palët e pranishme, prezantimin e gjykatës etj., duke orientuar drejt debatin dhe hetimin gjyqësor.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën, vendin dhe veprimet që kryhen në seancë dhe është nënshkruar nga gjyqtarja dhe sekretari gjyqësor. Procesverbali gjyqësor në të gjitha rastet është konstatuar se respekton kërkesat e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile (shihni dosjet 1, 2 dhe 5) apo të nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale (shihni dosjet 3 dhe 4). Gjithashtu, në të pesta dosjet gjyqësore janë përfshirë rregullisht aktet e paraqitura nga palët që kanë filluar procesin gjyqësor, aktet e shortit, aktet e caktimit të seancës së parë dhe njoftimet e palëve. Urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës janë pasqyruar/dokumentuar rregullisht në procesverbal, duke treguar arsyen dhe referencën ligjore.

3.Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në periudhën shtator 2004 – tetor 2005, subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin; në periudhën 14.11.1998 – 24.11.2008 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë; në vijim, në datën 24.11.2008 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Në datën 28.10.2016 është deleguar nga KLD-ja në funksionin e kryetares së kësaj gjykate. Në regjistrin e ankesave pranë KLD-së nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të subjektit. Ankesa të kësaj natyre nuk rezultuan as nga denoncimet e drejtpërdrejta në Komision.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në të pesta dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave dhe nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo i elementeve të tjera, që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në një rast në objektin e një çështjeje familjare ka pasur kërkime që lidhen me të miturit, por kjo çështje është zgjidhur nga gjyqtarja me vendim jopërfundimtar për kompetencën tokësore dhe, rrjedhimisht, nuk ka të dhëna për sjelljen e saj ndaj të miturve (shihni dosjen 5). Nuk është konstatuar që subjekti të këtë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave në gjykim.

4.Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave

paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse, pyetjeve të bëra nga gjykata ka qenë i qartë. Në të tria dokumentet ligjore dhe në pesta dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, znj. Albina Spaha, për të bashkëpunuar me kolegët dhe me administratën gjyqësore, si dhe të dhëna nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, madje edhe kur anëtarë të trupës gjyqësore kanë qenë të caktuar me delegim nga një gjykatë tjetër (shihni dosjen 4). Vonesat në fillimin e seancave gjyqësore kanë qenë të pakta në numër (3 seanca gjithsej) dhe deri në 17 minuta vonesë, gjë që nuk ka penguar ecurinë e seancës. Këto të dhëna tregojnë për një bashkëveprim normal me anëtarët e trupës gjyqësore dhe me administratën gjyqësore.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit është angazhuar thellësisht në aktivitete profesionale: i ka kushtuar rëndësi formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në të cilën ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 16 seminare të organizuara prej saj.

II. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në ankesat e subjekteve në KLD si më poshtë:

Subjekti i rivlerësimit ka të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ka ushtruar në këtë periudhë. KLD-ja i ka përcjellë materialet e shqyrtuara prej saj me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2018 (14 ankesa).

KLD-ja ka marrë në shqyrtim të gjitha ankesat e listuara në raportin e saj dhe ka arritur në përfundimin se faktet dhe shkaqet për të cilat janë bërë këto ankesa lidhen me mënyrën e përfundimit të themelit të çështjes gjyqësore dhe nuk ka indice për të provuar pretendimin e tyre, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, nuk ka indice për të provuar pretendimet, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

III. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në denoncimet e subjekteve si më poshtë:

Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim pesë denoncime nga publiku. Denoncimet hidhnin dyshime mbi: procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë procesit gjyqësor, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm, konfliktin e interesit etj.

Denoncim nr. *** prot., datë 30.11.2017, i shtetasit S.Q., – i cili e denoncon subjektin e rivlerësimit për shkelje të rënda ligjore, gjykim në kushtet e konfliktit të interesit, për vendim të padrejtë dhe për shpërdorim detyre.

Denoncim nr. *** prot., datë 29.12.2017 i shtetasit R. D. – i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe ndikim të paligjshëm në gjykim dhe vendimmarrje.

Denoncim nr. *** prot., datë 26.3.2018 i shtetasës L. L. – e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për njëanshmëri në gjykim, për korrupsion dhe për vendim të padrejtë.

Denoncim nr. *** prot., datë 21.9.2018 i shtetasit B. K. – i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për mitmarrje.

Denoncim nr. *** prot., datë 25.10.2018 i shtetasës M. K. – e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për procedura gjyqësore të padrejta, për mos-hetim dhe për vendim të padrejtë.

Pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku, raportin e vlerësimit të KLD-së, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore, në lidhje me denoncimet e mësipërme, nga Komisioni konstatohet se një denoncim i përket një gjykimi përpara vitit 2006 (rasti S. Q.); dy të tjera lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në themel (rastet L. L. dhe M. K.); një denoncim lidhet me mënyrën e përfundimit të gjykimit, por pa asnjë të dhënë gjyqësore (rasti B. K.) dhe për një denoncim, nuk rezultuan fakte të mbështetura në prova apo indice për përfshirjen e drejtpërdrejtë apo për ndërhyrjen e subjektit të rivlerësimit në çështjen në fjalë (rasti R. D.).

Për sa më sipër, Komisioni konkludoi se:

- ✓ Nuk ka prova për të provuar pretendimet e denoncuara, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në të shumtën e rasteve, faktet dhe shkaqet për të cilat bëhen ankesat lidhen me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit gjyqësor, të cilat kontrollohen dhe vlerësohen nga gjykata në nivel më të lartë sipas procedurës dhe këto nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në përfundim të vlerësimit, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, konstatohet se ky subjekt ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose të viktimave dhe është treguar efeciente dhe efektive në masë të pranueshme.

D. KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes dhe vëzhguesit ndërkombëtar, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, me funksion gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.4.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila Pine
Kryesuese

Pamela Qirko
Relatore

Genta Tafa (Bungo)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini